

LIGJ

Nr .9299, date 28.10.2004

PER ADERIMIN E REPUBLIKES SE SHQIPERISE NE VENDIMIN III/I,
AMENDAMENT I KONVENTES SE BAZELIT "PER LEVIZJEN NDERKUFITARE TE
MBETJEVE TE RREZIKSHME DHE ASGJESIMIN E TYRE"

Ne mbështetje te neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 te Kushtetutës, me propozimin e
Këshillit te Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon ne Vendimin III/1, amendament i Konventës se Bazelit "Për
lëvizjen ndërkufitare te mbetjeve te rrezikshme dhe asgjësimin e tyre".

Neni 2

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 4398, date 17.11.2004 te Presidentit te Republikës se Shqipërisë,
Alfred Moisiu

VENDIMI III/1
AMENDAMENT I KONVENTES SE BAZELIT

Konferenca,

duke rikujtuar se ne takimin e pare te Konferencës se Palëve te Konventës se Bazelit u shtrua
një kërkesë për ndalimin e transportimit te mbetjeve te rrezikshme prej vendeve te
industrializuara për vendet ne zhvillim;

duke rikujtuar vendimin II/12 te Konferencës,

duke vene ne dukje se:

- Grupi teknik i punës është instruktuar prej kësaj Konference për te vazhduar punën e saj
mbi karakterizimin e rrezikshmërisë se mbetjeve qe janë subjekt i Konventës se Bazelit
(vendimi III/12);
- Grupi teknik i punës ka filluar tashme punën e tij për përmirësimin e listave te mbetjeve qe
janë te rrezikshme dhe mbetjeve qe nuk janë subjekt i kësaj Konvente;
- Ato lista (dokumenti UNEP/CHW.3/Inf.4) japin udhëzime te rëndësishme, por nuk janë te
kompletuara apo te pranuar plotësisht;
- Grupi teknik i punës do te përgatisë udhëzime teknike për te asistuar çdo pale ose shtet qe
ka te drejtën te përfundojë marrëveshje ose rregullore, përfshirë atë sipas nenit 11 ne lidhje
me lëvizjet ndërkufitare te mbetjeve te rrezikshme.

1. Instrukton grupin teknik te punës qe t'i jepet prioritet te plote kompletimit te punës për
karakterizimin e rrezikshmërisë se mbetjeve dhe përmirësimin te listave dhe udhëzuesve
teknike ne mënyrë qe t'i paraqesë atë për miratim ne takimin e katërt te Konferencës se
Palëve;

2. Vendos qe Konferenca e Palëve do te marre ne takimin e katërt te saj një vendim mbi një/disa lista;

3. Vendos te adaptoje amendamentet e mëposhtme te Konventës:

"Futja e paragrafit te ri hyrës, 7 bis:

Duke pasur parasysh se lëvizjet ndërkufitare te mbetjeve te rrezikshme, sidomos për vendet ne zhvillim, rrezikojnë te mos marrin parasysh administrimin e drejte mjedisor te mbetjeve te rrezikshme, ashtu sikundër është kërkuar nga kjo Konvente"

Futja e nenit te ri 4A:

1. Çdo Pale e listuar ne aneksin VII duhet te ndaloje te gjitha lëvizjet ndërkufitare te mbetjeve te rrezikshme qe janë te destinuara për veprime sipas aneksit IV / A për ne shtetet qe nuk janë te listuara ne aneksin VII.

2. Çdo Pale e listuar ne aneksin VII duhet te heqë nga përdorimi prej datës 31 dhjetor 1997 dhe ndalohet qe nga kjo date te gjitha lëvizjet ndërkufitare te mbetjeve te rrezikshme sipas nenit 1 paragrafi 1(a) te Konventës, te cilat janë te destinuara për operacione ne përputhje me aneksin IV B ne shtetet qe nuk janë te listuara ne aneksin VII. Lëvizje te tilla ndërkufitare nuk do te ndalohen derisa mbetjet te jene te karakterizuara si te rrezikshme sipas Konventës.

ANEKS VII

Palët dhe shtetet e tjera te cilat janë OECD, EC, "Litenshtein".